



**“Diversifikimi i zërave në gazetari”
Grante për medie
Dokument me pyetje dhe përgjigje**

Ky dokument përfshin një listë jo-shteruese të pyetjeve që K2.0 ka pranuar rreth thirrjes për grante për medie. Për hir të qartësisë dhe transparencës, K2.0 ka mbledhur pyetjet më të rëndësishme që ka pranuar, bashkë me përgjigjet për to.

1. Çka është një “subjekt i vogël medial” për qëllimet e kësaj thirrjeje?

Subjektet e medieve private mund të aplikojnë në këtë thirrje vetëm nëse janë të përmasave të vogla. Për qëllime të kësaj thirrjeje, një subjekt i vogël medial është ai që përfshin 15 punonjës të brendshëm.

2. A mund të aplikojnë në këtë thirrje subjektet që kanë marrë grante nga K2.0 në të kaluarën?

Subjektet që kanë marrë më parë grante nga K2.0 mund të aplikojnë në këtë thirrje. Megjithatë, duhet ta kenë parasysh se juria do të përpiqet ta shmangë financimin e dyfishtë të subjekteve që tashmë pranojnë mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Ata duhet gjithashtu të kenë parasysh se qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është ta rrisë diversitetin e zërave në gazetari (dhe rrjedhimisht të përfituesve të granteve), diçka që do të merret parasysh në fazën e vlerësimit.

3. A mundet një grup individësh të krijojë një kolektiv të paorganizuar për të aplikuar në këtë thirrje?

Thirrja nuk parashikon kufizime kur bëhet fjalë për datën e themelimit të nismave të aplikuesve. Këtë e kemi bërë qëllimisht, duke ditur se data e themelimit nuk pasqyron gjithmonë përvojën dhe ekspertizën e një OJQ, subjekti medial privat ose nisme të paregjistruar. Një synim kryesor i kësaj thirrjeje është të kujdeset edhe për subjektet e reja, të cilat, për shkak se janë themeluar së fundmi, kanë vështirësi për të qasur në rrjedhat e rregullta të financimit dhe trajnimit.

Kësisoj, aplikantët duhet të kenë parasysh se:

1. Mundësitë e financimit në përgjithësi, duke përfshirë këtë në veçanti, synojnë të sigurojnë që mjetet e ofruara të kenë ndikim me kalimin e kohës, pra edhe pas përfundimit të projektit dhe mund të ndërtojnë në mënyrë të qëndrueshme kapacitetet e subjekteve pranuese. Për këtë arsye, subjektet që formohen ekskluzivisht për të marrë financim, normalisht nuk janë në gjendje të tregojnë, në fazën e vlerësimit, stabilitetin e nevojshëm për të marrë financim.
2. Individët nuk kanë të drejtë të marrin fonde sipas kësaj thirrjeje, duke përfshirë grupe individësh. Në këtë kuptim, iniciativat e paorganizuara nuk duhet të kuptohen thjesht si shtim i individëve në një subjekt të vetëm. Ngjashëm me subjektet e organizuara, iniciativat e paorganizuara kanë një vizion dhe mision të qartë dhe operacione kuptimplota — diçka që duhet dëshmuar në fazën e aplikimit.



4. Ne jemi OJQ e të rinjëve dhe fokusi jonë nuk është prodhimi i produkteve mediale. A kemi të drejtë të aplikojmë?

Kjo thirrje është e hapur jo vetëm për mediet (qofshin ato OJQ apo subjekte private), por edhe për organizatat me kapacitet, arsye ose përvojë të dëshmuar në prodhimin e përmbajtjes mediale. Kjo do të thotë se organizatat që nuk janë organizatë taman mediale kanë të drejtë të aplikojnë.

Si rezultat, nëse fokusi kryesor i një organizate nuk është gazetaria/prodhimi medial, organizata duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë aplikimit për të dëshmuar pse janë kandidat i përshtatshëm për të fituar grant në kuadër të kësaj thirrjeje, e cila ka për qëllim të mbështesë produkte cilësore mediale.

Për më tepër, palët e interesuara duhet të mbajnë mend se aplikantët mund të aplikojnë në konsorciume deri në dy subjekte të ndryshme. Nëse nuk jeni medie, ne do të shohim për mundësi bashkëpunimi me mediet tjera për shpërndarjen e produkteve mediale që dalin nga projekti.

5. Jemi të regjistruar si agjenci marketingu, por aktivitetet tona kryesore kanë të bëjnë me prodhimin inovativ medial. A kemi të drejtë të aplikojmë?

Agjencitë e marketingut, fokusi kryesor dhe fushat e funksionimit të të cilave janë të ngjashme me ato të një subjekti medial, mund të aplikojnë. Megjithatë, ato u nënshtrohen të njëjtave kërkesa për përshtatshmëri si subjektet e mediat private, veçanërisht kur bëhet fjalë për madhësinë e tyre. Agjencitë e marketingut duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë aplikimit të tyre, pasi që duhet të demonstrojnë pse dhe si funksionet e tyre janë të barabarta me ato të një subjekti medial dhe janë në përputhje me objektivat e kësaj thirrjeje.

6. Për arsye sigurie, nisma jonë e peregjistruar funksionon në kushte anonimiteti. A kemi të drejtë të aplikojmë?

Nëse gjejnë një sponsor fiskal, iniciativat e peregjistruara mund të aplikojnë edhe nëse ato funksionojnë në kushte anonimiteti. Megjithatë, ndonëse ne e mirëkuptojmë se disa iniciativa të peregjistruara duhet të funksionojnë në kushte anonimiteti — kushte që ne jemi të gatshëm t'i respektojmë në komunikimet tona me publikun — ju lutemi kini parasysh se K2.0 nuk mund t'i dhurojë fonde individëve të pidentifikuar, ose më mirë, subjekteve ose nismave që përbëhen nga individë që ne nuk jemi në gjendje t'i identifikojmë. Me fjalë të tjera, për ta vlerësuar një projekt propozim, duhet të dimë se kush do t'i marrë, përdorë dhe menaxhojë konkretisht fondet tona, për arsye llogaridhënieje ndaj donatorit dhe për arsye të transparencës financiare.

7. Subjekti jonë ka nevojë për pajisje. A mundet granti ta mbështesë blerjen e pajisjeve?

Kjo thirrje nuk përcakton kufizime për secilën kategori buxhetore dhe blerja e pajisjeve është një kosto e pranueshme. Megjithatë, ndërsa granti mund të përdoret për të mbështetur blerjen e



pajisjeve, aplikantët duhet të konsiderojnë se ne presim që buxhetet e propozuara të drejtohen kryesisht nëse jo ekskluzivisht për prodhimin e produktit medial. Me fjalë të tjera, fondet e alokuara për blerjen e pajisjeve (si dhe fondet që i përkasin kategorive të tjera buxhetore që nuk mbështesin drejtpërdrejt prodhimin e produktit medial) duhet të përbëjnë një pjesë të vogël të buxhetit të përgjithshëm. Domosdoshmëria e këtyre kostove për prodhimin e produktit brenda projektit duhet gjithashtu të justifikohet mjaftueshëm në aplikim.

8. Organizata jonë nuk ka llogari bankare. A mund ta ofroj identifikimin financiar të individëve të lidhur me organizatën?

Për të aplikuar në thirrje, subjektet e regjistruara duhet të kenë një llogari bankare operative që është në emër të njësisë ekonomike — që do të thotë se llogaritë bankare në pronësi të individëve, sado të lidhura me njësinë ekonomike, nuk janë të pranueshme. Vetëm nismat e peregjistruara mund të aplikojnë pa llogari bankare dhe për këtë arsye duhet të aplikojnë në konsorcium me një subjekt të regjistruar (me llogari bankare të vlefshme) i cili do të funksionojë si sponsor fiskal për nismën e peregjistruar.

9. Duam të aplikojmë me një projekt që përqendrohet në demaskimin e artikujve që përmbajnë dezinformata. Për të qenë të pranueshëm, a duhet të merremi me demaskimin e artikujve që kanë të bëjnë vetëm me pakicat?

Qëllimi i kësaj thirrjeje është “t’i kundërshtojë narrativat ekzistuese, që bazohen në informacione të pasakta ose jashtë kontekstit, sensacionalizëm ose stereotipe, si dhe ta sfidojë diskriminimin ose fshirjen e grupeve të ndjeshme, të drejtat dhe përjetimet e tyre nga debati publik”. Kësisoj prodhimet tuaja mediale duhet ta mbështesin “kulturën e të drejtave të njeriut dhe solidaritetit dhe të synojnë t’i nxjerrin në pah çështjet që janë të rëndësishme nga pikëpamja e drejtësisë sociale, të cilat ose tejkalohehen ose trajtohen sipërfaqësisht në medie”. Gjithashtu, “aktivitetet e përshtatshme për këtë thirrje janë prodhimet gazetareske, si: artikujt e shkruar, prodhimet multimediale, podcastët, video-prodhimet, produksionet dokumentare, emisionet e radios, shfaqjet televizive, animacionet dhe prodhime të tjera inovative mediale”.

Brenda këtij kuadri, ndihuni të lirë të propozoni aktivitete që kanë më shumë kuptim për ju, përvojën dhe objektivat tuaja specifike, për sa kohë që aplikacioni juaj shpjegon qartë pse aktivitetet e propozuara përputhen me objektivat e thirrjes. Në këtë kuptim, metodologjia dhe qasja gazetareske që planifikoni ta përdorni janë shumë të rëndësishme. Ju lutemi, kini parasysh gjithashtu se "grupe të cënueshme" përfshijnë shumë më tepër njerëz dhe përvoja sesa vetëm grupet e pakicave.